



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:067798

Datë: 20.05.2022

Numri i dokumentit: 03037347

PKR.nr.66/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me Kryetaren e Trupit gjykuese -gjyqtaren Violeta Husaj-Rugova me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bute Ramosaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit E. A nga P, shkak veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim te paautorizuar te armëve nga neni 366 par.1 te KPRK-se, dhe vepër penale posedim i pa autorizuar i narkotikeve substanca psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-se, sipas aktakuzës së prokurorisë themelore në Pejë departamenti i krimeve të rënda PP/I.nr.113/22 të dt. 13.04.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencë të prokurores së shtetit Lumturije Vuçetaj, të akuzuarit E A me dt. 17.05.2022 mori dhe publikisht shpalli, dhe me dt.20.05.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: E. A i biri i H dhe nenës R e gjinisë T i lindur me dt..... ne fshatin J Gj, tani me banim ne lagja posedon telefon me numër, i gjendjes se dobët ekonomike, ka te kryer shkollën e mesme punon si shofer ne “ identifikuar ne baze te letërnjoftimit me nr. Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Për shkak se:

I. Më parë e gjerë me dt.27.03.2022 rreth orës 13:00, në fsh. D.– R.K. Pejë, i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit Për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll armën –revolen Z.e zezë ...se bashku me 2 fishekë kalibër 9 mm, në atë mënyre që ditën kritike i pandehuri ndalohet në pikë kontrolli ne fsh. D.-R.nga njësia patrulluese- policia kufitare dhe gjatë kontrollit te veturës me ngjyrë te verdhë te cilën e drejtonte i pandehuri E, nën ulësen e te pandehurit, policia gjejnë dhe sekuestrojnë revolen me dy fishekë.

- Me çka ka kryer vepër penale “**Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve**” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

II. Më dt.27.03.2022 rreth orës 13:00, në fsh. D.– R.K. Pejë, pa autorizim ka poseduar substanca narkotike te llojit marihuan, në atë mënyre që ditën kritike i pandehuri pasi qe ndalohet në pikë kontrolli ne fsh. D.-R.nga njësia patrulluese- policia kufitare dhe gjatë kontrollit të veturës me ngjyrë te verdhë të cilën e drejtonte i pandehuri E, në veturë policia fillimisht e gjejnë një cigare të dëmtuar dhe meqenëse dyshojnë se në veturë mund të ketë substancë të dyshuar narkotike e njoftojnë njësitin e anti drogës të cilët vijnë në vendin e ngjarjes e kontrollojnë veturën, mirëpo nuk gjejnë asgjë të dyshimtë, më pas policia e arreston për armëmbajtje te

pandehurin E kurse dëshmitarit këtu pasagjeri E me urdhër te policisë e merr veturën e të pandehurit E dhe vazhdon rrugën para policisë ku gjatë rrugës i pandehuri E i dërgon sms dëshmitarit E duke i thënë të njëjtit qe tek ndërruesi i shpejtësisë gjendet e fshehur substanca narkotike, merre të njëjtën dhe hedhe, e të cilën substance narkotike dëshmitari E gjersa ndalet me mbush veturën me naftë e hedh në tokë me ç'rast nga polica sekuestrohet substanca narkotike dhe një gjysmë cigare xhoit dhe një mulli për bluarjen e marihuanës-grinder, një pako rizle e hapur e që substanca narkotike pas ekzaminimit ka rezultuar si e llojit "marihuan" në peshë 2.8 gram dhe "XH." në peshë prej 0.2 gram.

-me çka ka kryer veprë penale **"posedimi i pa autorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge"**, nga neni 269 par.2 lidhur me par. 1 te KPRK-se.

Andaj, gjykata konform nenit 7,17 par.1,38,39,40,43, 69, 70,76, nenit 366 par.1, 269 par 2 lidhur me par 1, te KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarin:

E GJYKON

Për veprë penale si në dispozitivin e parë të cekur më lartë, me dënim me gjobë në shumë prej 400€ (katërqind euro).

Për veprë penale ne dispozitivin e dytë të cekur si me lartë, me dënim me gjobë në shumë prej 300 €(treqind euro).

Konform nenit 76 par. 2 pika 2.4 të KPRK-së të akuzuarit i shqiptohet dënim unik me gjobë në shumën prej 700 € (shtatëqind euro).

Këtë dënim obligohet ta paguaj më së largu në afat prej 7 muaj nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe atë me 7 këste.

I akuzuari obligohet të paguaj këstin në shumë prej 100€ (njëqind euro) për çdo datë 1 (një) të muajit.

Në qoftë se i akuzuari nuk e paguan këstin me kohë atëherë të njëjtit mundësia e pagesës me këste do ti revokohet dhe i akuzuari obligohet të paguaj gjobën në tërësi.

Nëse i akuzuari dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj, gjykata do ti zëvendësoj pjesën e mbetur të gjobës në dënim me burgim, duke ju llogaritur 20€ (njëzet euro) një ditë burg.

Të akuzuarit i konfiskohet arma –revolja Z.e zezë ...se bashku me 2 fishekë kalibër 9 mm.

Të akuzuarit i konfiskohet gjysmë cigare "XH." në peshë prej 0.2 gram, si dhe një mulli për bluarjen e marihuanës – grinder, një pako rizle e hapur dhe substanca narkotike e llojit "marihuan" ne peshë prej 2.8 gram. Të njëjtat gjenden në ruajtje në zingjirin e ruajtjes sipas rastit policorë .-.-... dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e do të shkatërrohen.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 15€(pesëmbëdhjetë euro), si dhe shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr. 113/22 të dt. 13.04.2022, kundër të akuzuarit E.A nga P, për shkak veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-se, dhe veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikeve substanca psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-se.

Para se të lexoi aktakuzën prokurorja e shtetit fillimisht bënë plotësimin e kualifikimit juridik të veprës penale në numër rendore II, e cila duhet të jetë me çka ka kryer veprës penale “Posedim i pa autorizuar i narkotikeve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 prg 2 lidhur me par 1 të KPRK-se, në këtë rast bënë edhe plotësimin sa i përket e dispozitivit II, dhe atë në rreshtin e tretë para fundit pas fjalës në tokë duhet të jetë fjalia si në vijim : “ me ç’rast nga policia sekuestrohet substanca narkotike, dhe një gjysmë cigare XH., si dhe një mulli për bluarjen e marihuanes – grinder, një pako rizele e hapur, e qe substanca narkotike pas ekzaminimit ka rezultuar si e llojit “ marihuan” në peshë prej 2.8 gram dhe xhonit në peshë prej 0.2 gram.

Këtë plotësim e bënë bazuar në shkresat e lendes përkatësisht vërtetimi mbi sekuestrim si dhe raportit të analizës së narkotikeve të dt. 30.03.2022, si dhe propozon që të behet konfiskimi i dëshmimeve të sekuestruara sipas vërtetimit të dt. 27.03.2022, gjersa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar.

Pas leximit të aktakuzës së korrigjuar dhe të plotësuar nga ana e prokurores së shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 17.05.2022, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të drejtat e tij dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për fajësinë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i akuzuari E.A ka deklaruar: “se pasi që i kam kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë të cilat më janë shpjeguar nga ana e gjykatës deklaroi se e pranoj fajin për veprat penale për të cilën akuzohem, këtë pranim e beje vullnetarisht pa presion”.

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësinë ka deklaruar se: “ pajtohem me pranimin e fajësisë meqenëse një pranim i tillë është i bazuar në shkresat e lendes, kështu që i propozoj gjykatës që të njëjtën ta aprovtoj”.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit pasi që i njëjti i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për huthje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave.

Gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin bazuar në pranimin e fajësisë si dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës siç janë: raporti i oficerit V.Z me numër të rastit ...-...-... e dt.27.03.2022, raporti i oficerit V.Z e dt. 27.03.2022, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i lëshuar

në emër të E.A e dt. 27.03.2022, të dhënat e automjetit –, raporti i analizës se narkotikëve NarTest e dt. 30.03.2022, fotoja e armës dhe fishekëve, fotoja e substancës narkotike, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim gjykata i vlerësoj të gjitha rrethanat për dënimin konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoj se i akuzuari e ka pranuar fajësinë që në shqyrtim fillestarë, pastaj edhe rrethanat e tij familjare është babë i një fëmije. Ndërkaq si rrethana rënduese e mori sjelljen e tij të mëparshme ku i njëjti sipas raportit policorë të muajit mars 2022 rrjedhë se ishte i dyshuar për vepër për vepër penale të lëndimit të rëndë trupor në vitin 2015, pastaj pranë kësaj gjykate ka në zhvillim e sipër procedurën sipas aktakuzës PP/II nr. 1512/21 për vepër penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 185 par. 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të akzuarit, dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë si dhe gjendjen e tij ekonomike. Gjukata është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit, siç është pengimi i të akzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, gjithnjë duke u bazuar nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi u mor konform nenit 366 par.3 të KPRK-së dhe konform nenit 269 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e mori konform nenit 450 të KPRK-së.

Vendimi mbi konpensimin e viktimave të krimit u mor konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,
2022:067798, 20.05.2022**

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.